

Vendim nr. 154 datë 07.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 07.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (J) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: JUANA BUSHI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve të datës 25.10.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë “Për revokimin e vendimit të datës 19.01.2015 për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe caktimin e seancës në dhomë këshillimi pa praninë e palëve me datë 09.11.2022”; nr. 00-2022-4272 (584), datë 22.12.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

Dërgimi i çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore me praninë e palëve në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 e 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Juana Bushi (*kërkuesja*), e lindur në vitin 1998, është një prej trashëgimtarëve ligjorë të të atit të saj, i cili ka ndërruar jetë në datën 26.12.2004, si pasojë e një aksidenti automobilistik. Autori i aksidentit është dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat në datën 05.05.2005. Automjeti i të dënuarit ishte i siguruar me kontratën e lidhur në datën 02.07.2004 me shoqërinë e sigurimeve “Insig” sh.a., me afat deri në datën 01.07.2005.

2. Pas aksidentit automobilistik, e ëma e kërkueses, në cilësinë e përfaqësueses ligjore të dy fëmijëve të mitur (kërkuesja dhe vëllai i saj), ka paraqitur kërkesë pranë shoqërisë së sigurimeve për shpërblimin e dëmit. Në përgjigje të kësaj kërkesë, shoqëria e sigurimeve, me urdhrin e pagesës të datës 08.11.2005, iu ka ofruar shumën 1.603.620 lekë. Në datën 16.02.2006, e ëma e kërkueses ka lëshuar një deklaratë, në të cilën miratonte vlerën e dëmshpërblimit dhe shprehej se shoqëria e sigurimeve i kishte plotësuar detyrimet.

3. Në vitin 2013 kërkuesja dhe vëllai i saj, duke mos qenë dakord me vlerën e dëmshpërblimit, kanë paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, duke kërkuar shpërblimin e dëmit nga aksidenti automobilistik (dëmi pasuror në formën e shpenzimeve për perkujdesje dhe dëmi jopasuror, moral dhe ekzistencial), si dhe kamatat për vonesën e përmbushjes së detyrimit.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 1080, datë 30.09.2013, ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar shoqërinë e sigurimeve, ndër të tjera, t’i paguajë kërkueses shumat 786.674,2 lekë si shpërblim dëmi pasuror dhe 4.301.520 lekë si shpërblim dëmi jopasuror, si dhe kamatat respektive. Ajo ka arsyetuar se mosmarrëveshja lidhej me dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar nga humbja e jetës së të atit në aksident automobilistik dhe se padia ishte ngritur brenda afatit të parashkrimit. Për këtë të fundit, gjykata e shkallës së parë është shprehur se kërkimi për shpërblimin e dëmit jopasuror, është i lidhur me vetë personin dhe i patransferueshëm tek të tjerët, ndaj, bazuar në nenin 113, shkronja “a”, të Kodit Civil (KC), nuk parashkruhet, ndërsa kërkimi për shpërblimin e dëmit pasuror është paraqitur brenda afatit 3-vjeçar të parashikuar nga neni 115, shkronja “dh”, i KC-së, pasi bazuar në nenin 129, shkronja “d”, të të njëjtit kod, parashkrimi pezullohet deri 6 muaj pasi të miturve t’u emërohet një përfaqësues ose të mbushin moshën 18 vjeç. Kundër këtij vendimi ka paraqitur apel shoqëria e sigurimeve, duke pretenduar, ndër të tjera, se e drejta e padisë ishte parashkruar, ndërsa kërkuesja ka paraqitur apel kundërshtues.

5. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 902, datë 20.05.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se ai ishte i bazuar në prova dhe në ligj, përfshirë edhe interpretimin e ligjit mbi afatet e parashkrimit të së drejtës së padisë. Shoqëria e sigurimeve ka paraqitur rekurs kundër vendimit, duke dhënë si shkak edhe interpretimin e gabuar të ligjit material mbi parashkrimin. Ndërsa kërkuesja dhe vëllai i saj kanë paraqitur kundërrkurs, duke parashtruar se interpretimi i ligjit nga gjykata e faktit ishte i saktë.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, fillimisht, me vendimin e datës 19.01.2015, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Më pas, një tjetër trup gjykues i kësaj gjykate, me vendimin e datës 25.10.2022, bazuar në ndryshimet ligjore procedurale, ka vendosur revokimin e vendimit të datës 19.01.2015 dhe shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, me arsyetimin se kanë rënë shkaqet ligjore për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve ndërgjyqëse.

7. Në vijim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2022-4272 (584), datë 22.12.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe të Gjykatës së Apelit Vlorë, si dhe rrëzimin e padisë, me arsyetimin se ato ishin rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit. Sipas Gjykatës së Lartë, padia që ka për objekt shpërblimin e dëmit pasuror ose jopasuror, të shkaktuar nga fakti i paligjshëm, i dëmtimit të shëndetit ose i vdekjes, si pasojë e një aksidenti automobilistik, është padi për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, për të cilën zbatohet afati 3-vjeçar i parashkrimit i përcaktuar nga neni 115, shkronja “dh”, i KC-së. Në kushtet kur kërkuesja dhe vëllai i saj kanë qenë të mitur në kohën e aksidentit, ku ka humbur jetën ati i tyre, përfaqësimi ligjor në mbrojtje të drejtave dhe interesave të tyre, përfshirë atë të ngritjes së padisë në emër dhe për llogari të tyre, deri në plotësimin e afatit 3-vjeçar të parashkrimit, mund dhe duhej të realizohej nga e ëma, e cila e ka ushtruar e vetme përgjegjësinë prindërore ndaj tyre në zbatim të nenit 225 të Kodit të Familjes, duke mos u vërtetuar asnjë rrethanë për pamundësinë e realizimit të plotë të këtij përfaqësimi ligjor në rastin konkret. Me këtë arsyetim, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se afati i parashkrimit të padisë nuk mund të konsiderohej i pezulluar, ndaj e drejta e padisë sipas nenit 112 të KC-së ishte shuar dhe padia duhej rrëzuar.

8. Në vijim, kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), i cili është regjistruar në datën 22.05.2023, me objekt shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar të Gjykatës së Lartë.

II

Pretendimet e kërkuases

9. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmblëdhur, ka pretenduar se prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

- 9.1. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi vendimi i datës 19.01.2015, me të cilin Gjykata e Lartë ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve, është i formës së prerë dhe nuk mund të diskutohet më nga një trup tjetër gjykues i së njëjtës gjykatë. Ky lloj vendimi nuk është i ndërmjetëm, por përfundimtar i një lloji *sui generis*, pasi i jep fund fazës së parë të shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë. Si i tillë, ai është i detyrueshëm për palët ndërgjygjëse, sikurse edhe për gjykatën që e ka dhënë atë, ndaj revokimi i tij me vendimin e datës 25.10.2022 ka cenuar *parimin e gjësë së gjykuar*. Pranueshmëria e rekursit është mbështetur në legjislacionin procedural civil që ka qenë në fuqi në vitin 2012 në momentin e depozitimit të tij, ndërsa gjykimi në dhomën e këshillimit është kryer në bazë të legjislacionit në fuqi, në bazë të vendimit të revokimit të datës 25.10.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- 9.2. *E drejta për t'u mbrojtur*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar kërkuesen për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit dhe as për vendimin e revokimit të datës 25.10.2022. Gjykata e Lartë nuk ka kryer shpalljen për gjykimin e çështjes në dhomën e këshillimit, siç parashikohet në ligj. Mungesa e njoftimit i ka mohuar kërkuases të drejtën për t'u mbrojtur nëpërmjet paraqitjes së pretendimeve me shkrim para gjykatës.
- 9.3. *Parimi i gjykatës së caktuar me ligj i lidhur me ndalimin e fuqisë prapavepruese të ligjit procedural civil*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka verifikuar tagrat e përfaqësimit të kërkuases. Në dosjen gjyqësore gjendej prokura e posaçme e datës 11.03.2013, kohë në të cilën ajo ishte e mitur dhe zgjedhja e avokatit ishte bërë nga e ëma, ndërsa në kohën e gjykimit, që përfundoi me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 22.12.2022, kërkuësja ishte madhore, ndaj përfaqësuesi i zgjedhur nga e ëma nuk kishte më tagra përfaqësimi.
- 9.4. *Parimi i barazisë para ligjit, parimi i barazisë së armëve, standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, si dhe *e drejta e pronës*, kjo e fundit e garantuar edhe nga neni 41 i Kushtetutës, si pasojë e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitetit është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuësja të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

12. Kolegji vlerëson se kërkuësja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuësja ka kundërshtuar vendimin e revokimit të datës 25.10.2022, si dhe vendimin përfundimtar të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të iniciuar prej saj. Në këtë situatë,

Kolegji vlerëson se mjeti i vetëm i ankimit në dispozicion të kërkukses është ankimi kushtetues individual, ndaj përmbushet kriteri i shterimit të mjeteve juridike.

15. Kolegji çmon se kërkuksja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi përfundimtar i Gjykatës së Lartë mban datën 22.12.2022, kurse ankimi kushtetues individual është dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 20.04.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

16. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji thekson se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuksin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur.

17. Në çështjen konkrete, kërkuksja ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e parimit të barazisë para ligjit, parimit të barazisë së armëve, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe të së drejtës së pronës, duke u mjaftuar vetëm me përmendjen e këtyre parimeve dhe të drejtave, pa paraqitur asnjë argument konkret. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim, pasi nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

18. Gjithashtu, në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuksja ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe i kanë dhënë fuqi prapavepruese ligjit procedural civil, pasi Gjykata e Lartë nuk ka verifikuar tagrat e përfaqësimit të saj, në kushtet kur përgjatë intervalit kohor prej më shumë se 8 vjetësh të shqyrtimit të rekursit, kërkuksja ka mbushur moshën madhore dhe nuk përfaqësohej më nga e ëma. Kolegji, duke evidentuar se në ankim nuk paraqitet ndonjë argument juridik se si çështja e përfaqësimit ligjor të kërkukses lidhet dhe ndikon në parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe në atë të veprimit në kohë të ligjit procedural, vëren se kërkuksja, edhe pse e mitur, prezumohet se ka pasur dijeni rregullisht për procesin gjyqësor që pritej të zhvillohej nga Gjykata e Lartë. Ky fakt konfirmohet nga paraqitja e kundërrekursit prej saj, si dhe nga parashtrimet në ankimin kushtetues, me të cilat ajo pretendon se ka marrë njoftim rregullisht për vendimin e datës 19.01.2015 të Kolegjit Civil për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Në këtë kuptim dhe duke iu referuar rregullave të përgjithshme të përfaqësimit, si marrëdhënie që krijohet dhe ndryshohet me vullnetin e palëve, madje edhe ratifikohet më vonë nga i përfaqësuari, kur përfaqësuesi vepron pa tagra, Kolegji vëren se në ankim nuk paraqitet asnjë shpjegim përse vetë kërkuksja nuk e ka njoftuar Gjykatën e Lartë për vullnetin e saj për të ndryshuar përfaqësuesin dhe nëse ka pasur ndonjë pengesë të përligjur

për këtë mosveprim. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se edhe këto pretendime të kërkuases nuk mund të merren në shqyrtim, pasi argumentet e paraqitura janë të pamjaftueshme.

19. Për sa u takon pretendimeve të tjera, që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektet e parimit të sigurisë juridike dhe së drejtës së mbrojtjes, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, ato *prima facie* hyjnë në kompetencën e Gjykatës, ndaj do të analizohen në vijim.

A.1. Për pretendimin e cenimit të sigurisë juridike

20. Kërkuësja ka pretenduar se vendimi i datës 19.01.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore është i formës së prerë dhe nuk mund të revokohej më nga një kolegji civil i së njëjtës gjykatë, pasi e ndalon neni 451/a i KPC-së që parashikon rregullat për gjënë e gjykuar. Vendimi i datës 19.01.2015 nuk është i ndërmjetëm, por vendim përfundimtar i fazës së parë të shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, i një forme *sui generis* dhe i detyrueshëm për palët ndërgjyqëse, sikurse edhe për gjykatën që e ka dhënë atë dhe revokimi i tij cenon parimin e gjësë së gjykuar. Po ashtu, sipas kërkuases, pranueshmëria e rekursit është mbështetur në legjislacionin procedural civil që ka qenë në fuqi në vitin 2012 në momentin e depozitimit të tij, ndërsa gjykimi në dhomën e këshillimit është kryer në bazë të legjislacionit në fuqi në vitin 2022.

21. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar lidhjen që siguria juridike ka me të drejtën kushtetuese të procesit të rregullt, në të cilën ky parim përgjithësisht shfaqet në formën e gjësë së gjykuar. Mosrespektimi i gjësë së gjykuar shkakton cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pra cenon vetë sigurinë juridike. Në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, atëherë asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 17, datë 30.03.2021; nr. 50, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në çështjen konkrete rezulton se me vendimin e datës 19.01.2015 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Më pas, një tjetër trup gjykues i po asaj gjykate, me vendimin e datës 25.10.2022, bazuar në ndryshimet ligjore procedurale, ka vendosur revokimin e vendimit të datës 19.01.2015 dhe shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, me arsyetimin se kanë rënë shkaqet ligjore për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve ndërgjyqëse. Në përfundim, me vendimin nr. 00-2022-4272 (584), datë 22.12.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur

ndryshimin e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe të Gjykatës së Apelit Vlorë, dhe rrëzimin e padisë.

23. Duke i analizuar këto rrethana dhe llojin e vendimit të themelit që ka dhënë Gjykata e Lartë në përfundim të procesit, Kolegji vëren se vendimi i datës 25.10.2022 nuk ka revokuar fazën e shqyrtimit të rekursit nga ajo gjyqësore në shqyrtim paraprak, por ka revokuar mënyrën e zhvillimit të seancës gjyqësore, nga ajo publike me pjesëmarrjen e palëve, në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh. Lidhur me seancën mbi bazë dokumentesh, Gjykata ka pohuar se në procedurat që përfshijnë vetëm çështje të ligjit, në dallim nga ato të faktit, zhvillimi i gjykimit mbi bazë të dokumenteve, pra mosdëgjimi personalisht i kërkuesit, nuk përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor, pasi kjo justifikohet me veçoritë e procedurave, me kusht që në shkallë të parë të jetë zhvilluar një seancë dëgjimore (*shih vendimin nr. 28, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Për sa më lart dhe duke mbajtur në konsideratë kompetencat kushtetuese të Gjykatës së Lartë për interpretimin e ligjit, si dhe faktin se gjykimi i çështjes së kërkueses në shkallë të parë dhe të dytë është zhvilluar në seancë publike, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike është haptazi i pabazuar.

A.2. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes

25. Kërkuesja ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk e ka njoftuar për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit dhe as për vendimin e revokimit të datës 25.10.2022. Sipas saj, Gjykata e Lartë nuk ka kryer shpalljen për gjykimin e çështjes në dhomën e këshillimit siç parashikohet në ligj dhe mungesa e këtij njoftimi i ka mohuar kërkueses të drejtën për t'u mbrojtur nëpërmjet paraqitjes së pretendimeve me shkrim para gjykatës.

26. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar e për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën

kundërshtare. Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë dokumentesh, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 21, datë 04.04.2016; nr. 37, datë 30.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Bazuar në nenin 482, pika 1, të KPC-së, shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit. Për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë, ligji procedural civil përcakton se sekretaria e saj njofton palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjykimit të paktën 15 ditë përpara. Kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara ose të njohura, sekretaria kryen njoftimin edhe në këto adresa (*neni 482, pika 3, i KPC-së*).

28. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, vëren se Gjykata e Lartë i ka dërguar kërkuases njoftimin nr. 11243-03462-00-2014, datë 26.10.2022, për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit në datën 09.11.2022, bashkëlidhur së cilit është përcjellë edhe vendimi për revokim i datës 25.10.2022. Ky njoftim është marrë në dorëzim në datën 27.10.2022 dhe është nënshkruar nga e ëma e kërkuases. I njëjti njoftim i është dërguar edhe përfaqësuesit ligjor të kërkuases, i cili rezulton t'i këtë marrë në dorëzim kundrejt nënshkrimit në datën 28.10.2022. Në përgjigje të njoftimit, përfaqësuesi i kërkuases ka depozituar në Gjykatën e Lartë parashtimet e datës 31.10.2022, për llogari të kërkuases dhe vëllait të saj.

29. Referuar procesverbalit të datës 09.11.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur të shtyjë shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit në një datë tjetër. Nga verifikimet e kryera në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “Çështje të shpallura në gjykim”, ku pasqyrohen të dhënat e çështjeve për shqyrtim në dhomën e këshillimit, përfshirë datën e shpalljes, numrin e çështjes, palët ndërgjyqëse, bazën ligjore, trupin gjykues, relatorin, datën dhe orën e shqyrtimit, Gjykata e Lartë ka publikuar në datën 15.12.2022 listën e çështjeve për shqyrtim në dhomën e këshillimit nga Kolegji Civil në datën 22.12.2022, ku përfshihej edhe çështja e kërkuases.

30. Në këto rrethana, Kolegji vëren se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuësja në ankimin e saj kushtetues, ajo ka marrë njoftim të rregullt për vendimin e revokimit të datës 25.10.2022, si dhe për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit në datat 09.11.2022 dhe 22.12.2022. Përfaqësuesi i saj ka paraqitur edhe prapësime me shkrim për llogari të saj, duke ushtruar efektivisht të drejtën e mbrojtjes. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuases për cenimin e së drejtës së mbrojtjes është haptazi i pabazuar.

31. Në përfundim të analizës për kriteret paraprake, Kolegji çmon se çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.